

Nr. Prot. RL 1

Tiranë me dt.02/06/2026

## FTESË PËR OFERTË

**Emri:** Milieukontakt Shqipëri  
**Adresa:** Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion,  
 Shk.3, Ap.8 Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri  
**E-mail:** [office@milieukontakt.org](mailto:office@milieukontakt.org)  
**Afati i dorëzimit të ofertës:** 12/06/2026

Milieukontakt Shqipëri po zbaton projektin projektit “*Forcimi i menaxhimit të mbetjeve përmes planifikimit dhe rregullimit vendor në Kavajë*”. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti organizata kërkon të realizojë procedurën e prokurimit e thjeshtë për Sherbim ekspertize “**Ekspert për hartimin e rregullores per menaxhimin e mbetjeve**”.

### Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet apo personat fizik të interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më **12 Qershor 2026**, në adresën e e-mailit: [office@milieukontakt.org](mailto:office@milieukontakt.org) ose nëpërmjet postës në adresën Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri. Ofertat e dorëzuara dorazi nuk do të merren në konsideratë.

### Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Milieukontakt Shqipëri do të zhvillojë procedurën e prokurimit për ekspertizë **Ekspert për hartimin e rregullores per menaxhimin e mbetjeve** sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i ekspertizës	Ditë Pune	Çmimi/njësi Lekë	Çmimi total Leke (TVSH e perfshire)
1.	Hartimi i rregullores per menaxhimin e mbetjeve	14		
	<b>Totali</b>			

## **PERSHKRIMI SHËRBIMIT**

Qëllimi i këtij shërbimi është ofrimi i ekspertizës për hartimin e Rregullores së Menaxhimit të Mbetjeve, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi, standardet mjedisore dhe dokumentet strategjike të Bashkisë.

Eksperti ose kompania e kontraktuar do të hartojë rregulloren duke siguruar përputhshmërinë e saj me kuadrin ligjor dhe institucional, si dhe me Planin e Menaxhimit të Mbetjeve që do të hartohet në kuadër të projektit.

## **DETYRAT**

Eksperti/kompania do të realizojë këto detyra:

- Shqyrtimin e legjislacionit kombëtar dhe lokal në fushën e menaxhimit të mbetjeve;
- Konsultimin me Bashkinë dhe institucionet përgjegjëse për çështjet e menaxhimit të mbetjeve;
- Bashkëpunimin dhe koordinimin me ekspertin që do të hartojë Planin e Menaxhimit të Mbetjeve, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë dhe harmonizimit ndërmjet dy dokumenteve;
- Hartimin e draft-rregullores për menaxhimin e mbetjeve;
- Integrimin në rregullore të procedurave, roleve dhe mekanizmave të nevojshëm për zbatimin efektiv të sistemit të menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor.

Rregullorja duhet të përfshijë, ndër të tjera:

- Procedurat për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve;
- Ndarjen, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve;
- Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit;
- Përgjegjësitë e strukturave bashkiake dhe aktorëve të tjerë të përfshirë;
- Masat administrative dhe procedurat e zbatimit të rregullores.

## **PRODUKTET QË DO TË DORËZOHEN**

Në përfundim të shërbimit, eksperti/kompania do të dorëzojë:

- Draft-rregulloren dhe versionin përfundimtar të Rregullores së Menaxhimit të Mbetjeve;
- Formatet, procedurat standarde dhe instrumentet mbështetëse të nevojshme për zbatimin e rregullores.

## KRITERET E PËRGJITHSHME

- Përvojë në hartimin e akteve rregullatore, politikave ose planeve në fushën e mjedisit;
- Përvojë specifike në menaxhimin e mbetjeve;
- Njohje të legjislacionit kombëtar dhe standardeve ndërkombëtare për mbetjet;
- Realizimin e kontratave të ngjashme gjatë viteve të fundit.
- Preferohen kandidatë me veprimtari në Bashkinë Kavajë.
- Eksperti duhet të përfshijë në ofertën e tij të gjitha kostot teknike, logjistike (transport, dieta, pajisje të nevojshme, etj.) dhe financiare.

## Kualifikimet e ekspertit

Eksperti duhet të ketë:

- Diplomë universitare në mjedis, inxhinieri mjedisore, juridik ose fusha të ngjashme;
- Minimumi 5 vite eksperiencë profesionale relevante;
- Eksperiencë në hartimin e rregulloreve ose dokumenteve strategjike;

Të gjithë subjektet apo personat fizik të interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më **12 Qershor 2026**, në adresën e e-mailit: [office@milieukontakt.org](mailto:office@milieukontakt.org) ose nëpërmjet postës në Adresën Rr. 'Xhorxhi Martini', Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri. Ofertat e dorëzuara dorazi nuk do të merren në konsideratë.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën. Pagesa e subjektit/personit fizik do të kryhet me transfertë bankare në monedhën Lekë, pas përfundimit të shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse, ose si subjekt i tatimit mbi të ardhurat (15%) sipas legjislacionit shqiptar.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Krahas ofertës financiare (aneks i ftesës), duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) CV ku të tregohen eksperiencat e mëparshme
- 2) Ekstraktin e QKB në rastin kur është subjekt, ose ID në rastin e personit fizik;
- 3) Numrin e llogarisë bankare.